



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **46**

Prishtinë, më 12.5.2009, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Lulzim Zeneli, Naim Maloku, Myrvete Pantina, Elheme Hetemi, Heset Cakolli, Berat Luzha.

Munguan : Selvie Halimi, Zulfi Merxha, Zef Morina, Dragiša Mirić, Ali Lajçi.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : Enver Tahiri nga MMPH, nga OSCE Blerim Vela dhe Maria Berishaj dhe vëzhgues tjerë.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku, Mustafë Nuhiu.

Mbledhjen e kryesoi **Lulzim Zeneli**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Raporti i MMPH rreth gjendjes së mbeturinave në Kosovë,
3. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar me vërejtjet si vijon :

1. Në pikën tre të përfundimit të komisionit për vlerësimin pozitiv të raportit nga ZRRUM të shtohet pika : **Raportet në mes ZRRUM dhe MMPH do të qartësohen me rekomandimet e këtij komisioni në fund të monitorimit të Ligjit për Mbeturina kur do të hartohen rekomandimet për Kuvendin e Kosovës, duke sugjeruar ndryshimin e Ligjit ekzistues për mbeturina.**

2. Diskutimi i Elheme Hetemit përmirësohet si vijon : **Elheme Hetemi** konstatoi se ujësjellësit e zonave rurale funksionojnë me mjaft vështirësi, ndaj pyeti si menaxhohen dhe sa kontrollohen ato nëpër këto zona duke shprehur shqetësimin për ujin e pijes që përdoret nga banorët aty lidhur me sigurinë shëndetësore të tyre.

2. Raporti i MMPH për gjendjen e mbeturinave në Kosovë

Lulzim Zeneli falënderoi zyrtarin nga MMPH për përgjigje në ftesën e komisionit rreth këtij raporti, ndërkaq hapi debatin rreth tij.

Heset Cakolli konstatoi se raporti është gjithëpërfshirës duke konstatuar gjendjen jo të mirë në teren. Ai pyeti për fatin e mbeturinave siç janë vajrat, bateritë, katalizatorët etj si burime që dëmtojnë rëndë mjedisin dhe si menaxhohen këto mbeturina.

Myrvete Pantina gjithashtu konstatoi se raporti paraqet realitetin që ekziston lidhur me mbeturina dhe ftoi komisionin të angazhohet rreth emërimit të inspektorëve mjedisor nëpër komuna, pasi që shumë komuna nuk i kanë, si pasojë e së cilës nëpër komuna punohet pa leje dhe lë hapësirë për veprime të pakontrolluara, udhëzimet administrative nuk i kanë afatet si duhet ose fare nuk i kanë.

Berat Luzha mori shembull mbeturinat metalike të cilat duhet të menaxhohen mirë, sepse ka shumë sosh që nuk duhet të eksportohen (largpërçues, shenjat e komunikacionit etj), qeset e najlonit të cilat dëmtojnë tokën duke mos u tretur si dhe shkarkimin e mbeturinave në vend e pavend.

Naim Maloku pyeti se si të dilet nga kjo gjendje me mbeturina, çfarë aktivitete të ndërmerren, si të veprohet në MMPH dhe në Komuna, si të zbatohen të shkruarat e raportit në faqen 7 (ripërdorimi, fitimi i energjisë nga mbeturinat me djegëje etj), ku ka mbetur MMPH me projekte etj.

Lulzim Zeneli gjithashtu konstatoi këtë raport mjaft reale, i cili në fakt paraqet një pasqyrë të gjendjes ekzistuese. Ai u angazhua për politikat operacionale konkrete si dhe të njoftohet ky komision deri ku ka shkuar MMPH në krahasim me shtetet e rajonit të cilat kanë propagandë të fuqishme rreth mbeturinave, çka një gjë e tillë te ne mungon, sidomos sa i përket riciklimit të mbeturinave, si dhe donatorët e huaj sa kontribuojnë në këtë drejtim me financim. Edhe pse është gjendje e keqe sa i përket mbeturinave, ne duhet atë ta paraqesim përmes rekomandimeve dhe raportit në fund, përfundoi.

Enver Tahiri duke jap përgjigje në pyetje dhe komente, tha së pari për vajra dhe bateritë se ato mbeturina fatkeqësisht përfundojnë në kanale, edhe pse MMPH ka nxjerr udhëzimin për djegëjen e tyre në furrën mbi 350 gradë. Ligjet, fatkeqësisht nuk lexohen, konstatoi ai.

Më tutje vazhdoi me konstatimin se nëpër komuna nuk ka inspektor mjedisor çka paraqet gjendjen që reflekton punën e deritashme, zgjidhja është se duhet të zbatohen 22 udhëzimet e MMPH.

Lidhur me hekurin ai u përgjigj se me të madhe vidhet pasi që paguhet mirë dhe fatkeqësisht këto mbeturina marrin lejen për eksport. Tani është në fuqi ligji për eksport, import e transport dhe të shohim se si dhe sa do të zbatohet, tha ai.

Qeset e najlonit nuk ndalohen nga askush për shkarkim në vend e pavend, por me këtë problem duhet të mirët më tepër ZRRUM.

Fitimi i energjisë me djegëjen e mbeturinave ka qenë në diskutim me shumë ekspert që kanë gravituar këtu me projekte të ndryshme të trajtimit të mbeturinave. Edhe pse MMPH ka lejuar një gjë të tillë ato nuk janë realizuar sepse p.sh. në disa deponi nuk janë lejuar të hyjnë investuesit nga ana e AKM.

Incenerimi apo djegëja e mbeturinave në Kosovë bëhet nga incenerator të dobët të cilët më tepër ndotin se sa që bëjnë mirë djegëjen, sidomos të mbeturinave medicinale, PCT-ve etj.

Ai në fund tha se MMPH ka kërkuar nga AKM që me rastin e shitjes së ndërmarrjeve të epen edhe disa probleme të mbetura me atë ndërmarrje p.sh. maunat etj, ndaj konstatoi se MMPH do të bëjë edhe më tepër se sa që është treguar në raport si dhe do të hartoi strategjinë.

Lulzim Zeneli falënderoj dhe përsëriti kërkesën që MMPH të furnizoi këtë komision me ndonjë strategji të hartuar ose që do të hartohet, së paku për 1 vit, sepse si tha ai ka informata se janë investuar qindra miliona euro në këtë drejtim. Një strategji në këtë fushë do të ndihmonte të shihet se sa ka pasur financim dhe sa janë të arriturat.

Blerim Vela me disa pyetje dhe kërkesa bëri plotësimin e raportit si vijon :

- Ky raport duhet të zyrtarizohet nga MMPH,
- Të tregohen më saktë burimet e informacioneve që cekën,
- Raporti të pasqyroj nivelin se ku jemi në këtë fushë në krahasim me vendet e rajonit,
- Nuk është treguar si bëhet regjenerimi i mbeturinave pas hyrjes në fuqi të ligjit për Mbeturina (pas vitit 2004),
- Të ceket lista e deponive me adresë të saktë,
- Aktet nënligjore

Lulzim Zeneli përfundoi me pajtimin e komisionit me këtë :

K O N K L U D I M

Tani e tutje komisioni fillon fazën e tretë të monitorimit të Ligjit për Mbeturina, vizitat në teren.

MMPH-Departamenti për menaxhimin me mbeturina, deri në javën e ardhshme duhet të sugjeroi :

- **5 komuna të cilat do të vizitohen nga grupi i caktuar në komision. Këto komuna duhet të pasqyrojnë saktë gjendjen reale sa i përket mbeturinave në Kosovë : një Komunë si shembull pozitiv, një Komunë si shembull negativ dhe tri Komuna tjera si shembuj mesatar.**
- **Planin e vizitës dhe personat me të cilët duhet të komunikoi grupi në teren.**

3..Të ndryshme

1. Lulzim Zeneli njoftoi komisionin për një ftesë që do të bëhet së shpejti nga shoqata e Gollakut në Keqekollë rreth prodhimeve bujqësore, dhe luti komisionin të caktohet delegacioni dhe agjenda. **Naim Maloku** propozoi të ftohet edhe një përfaqësues i MBPZHR, me çka u pajtua komisioni.

2. Sipas propozimit të Naim Malokut, komisioni kërkoi që kryetari **Lulzim Zeneli** të kontaktoi me ambasadën Amerikane rreth projektligjit për rrezatimin jonizues, jojonizues dhe siguri nukleare, se çfarë propozimesh kanë :

1. të amendamentohet ky projektligj dhe ti dërgojnë vërejtjet nga kjo ambasadë, apo
2. të rihartohet një projektligj tjetër, me ç'rast komisioni do të rekomandoi seancës plenare t'i kthehet Qeverisë.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 15,00, mbledhja e radhës do të caktohet gjatë javës.

Kryetari i Komisionit,
Lulzim Zeneli